



## PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më **15.05.2015**, me fillim në ora **10.15**. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Nahit Elshani**.

**Kryesuesi Elshani** – Fillimisht më lejoni të përshëndes Nënkrjetarin e komunës z. Xhemali Haxhimustafa, , delegatët e pranishëm në këtë seancë, përfaqësuesit e OSBE-së, monitoruesin e KDI-së, përfaqësuesit e medieve dhe të gjithë të pranishmit e tjerë. Ju paraqes rendin e ditës të paraparë për këtë mbledhje:

### Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i Raportit financiar për periudhën janar – Mars 2015,
3. Formimi i komiteteve tjera dhe
4. Të ndryshme.

**Kryesuesi** – E qes në aprovim rendin e ditës: Konstatoj që në mënyrë unanimit është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës,

**1.Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**, vërejtje nuk ka pas nga ana juaj në postë elektronike, ka dikush tash të shtoj diçka, nëse nuk keni e qes në aprovim procesverbalin: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar edhe procesverbali. Kalojmë në pikën e radhës:

**2. Shqyrtimi i Raportit financiar për periudhën janar – Mars 2015,**

**Lulzim sylejmani** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ne sot para jush jemi duke e prezantuar raportin 3 mujor të shpenzimeve dhe të realizimit të buxhetit për vitin 2015, në këtë përmbledhje të këtij raporti kemi pasqyruar pasqyrat e të hyrave vetanake, planifikimi dhe realizimin për këtë muaj, të dhënat përmbledhëse dhe krahasimi i tyre për periudhën Janar – Mars, krahasimi i të hyrave në gjobat e trafikut të gjykatave Janar – Mars, krahasimi i të hyrave Janar – Mars sipas kodeve ekonomike, realizimi i të hyrave nga tatimi në pronë për periudhën raportuese, realizimi dhe shfrytëzimi i buxhetit për këtë periudhë, përmbledhja e raporteve të projekteve kapitale sipas të dhënave që na ka siguruar zyra e prokurimit dhe në funde janë obligimet e raportit siç ka qenë me 31 dhjetor 2014 dhe 31 Mars 2015. Në përgjithësi unë mendoj se trendi i buxhetit të komunës së Rahovecit shkon drejt normalizimit në bazë të atyre faturave që ne i kemi trashëguar në fund të vitit 2013 dhe tash në bazë të raportit të obligimeve krahasimi është dukshëm i përmisuar dhe trendi i përmisimit shkon gjithmonë drejt një normaliteti. Sa i përket të hyrave të realizuar kemi një rritje në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, por nuk është i kënaqshëm duke llogaritur që planifikimi na dallon nga viti 2014, sepse në vitin 2014 planifikimi ka qenë 950.000.00 € ndërsa në vitin 2015 planifikimi është 1.1 milion. Realizimi për këtë periudhë 3 mujore nuk është shumë i kënaqshëm, tek kjo ka ndikuar edhe deklarata dhe draft ligji që është duke u punuar për faljen e borxheve të akumuluar deri në fund të vitit 2008. Sa i përket të hyrave nga gjobat e gjykatës për shkak të konfiskimit të dokumenteve në vitin e kaluar kemi pas të hyra të jashtëzakonshme, ndërsa tash për shkak të mos konfiskimit të dokumenteve trendi i të hyrave nga kjo kategori është duke ra. Të hyrat nga tatimi në pronë për të njëjtën periudhë krahasuese kemi një progres të vogël por nuk është shumë i kënaqshëm. Shpenzimi i buxhetit për periudhën 3 mujore janar – mars 2015 në paga është një shfrytëzim prej 24.69 %, mallra dhe shërbime kemi 15.95%, shpenzime komunale 27.94 %, subvencione 18.49 %, investime kapitale 20.05 %, në total buxheti i komunës së Rahovecit për periudhën 3 mujore është shfrytëzuar 22.68 %. Kjo përqindje buxhetit është pakës e ulët për shkak se në muajin mars sistemi i pagesave friballans nuk ka

funksionuar fare, dhe në këtë muaj nuk kemi mundur të bëjmë pagesa në kategori tjera përveç në paga. Në fund obligimet e faturuara nëse e bëjmë një krahasim në mënyrë kronologjike që nga viti 2013 ju siç e dini në funde të vitit 2013 ne kemi trashëguar një vlerë të faturës 2.2 milion € dhe në fund të vitit 2014 kemi 731,551.70 € dhe në fund të 3 mujorit janar - mars 2015 fatura në pritje kanë qenë 311,748.53 €.

**Selim Duraku** - Përshëndetje për të gjithë, tek tatimi në pronë e kam të pa qartë tek m2 sepse në vitin 2014 janë regjistruar 99.134 m2, ndërsa në 2015 është 54.000 m2, dua ta di se ky çmim a është për 3 muaj apo për një vite. Mendoj se investimet kapitale për këtë 3 muaj kanë qenë shumë të vogla por besoj se që nga ky muaj do të bëhen investime ma të shumta. Tek kontratat e nënshkruara publike sinjalizimi i vertikal dhe horizontal si dhe vendosja e pengesave në rrugë e shoh që është ndarë një shumë prej 30.000 € komuna jona ka nevojë për këto sinjalizime sepse ka mungesa të shumta, ne nuk jemi të informuar a ka përfunduar kjo kontrata apo ende jo. Rregullimet e kanalizimeve fekalet atmosferike në qytetin e Rahovecit duhet të rregullohen sepse kohët e fundit vërshimet që kanë ndodhur në qendër të qytetit nga kanalizimi e gjithë rruga bëhej e pa pastër nga ujërat e zeza.

**Fatmir Iska** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, faqe 4 tabela numër 1 pasqyrat mujore për të hyrat vetanake për 3 muaj i kemi të realizuara 196,49.38 €, që në përqindje i bie 17.84 % kurse plani i të hyrave është 1.1 milion € dhe unë nuk besoj se mundet të realizohet ky planë për arsye të inkasimit të paktë të hyrave vetanake. Të hyrat nga gjoba në trafik e përmendi drejtori po ashtu edhe unë pajtohem me të se nga mos marrje të dokumenteve të dënuarit do të ikin nga pagesa e gjobave po ashtu janë edhe afatet e parashkrimet që kalojnë. Në këtë raporte financiar mungon pjesa e rëndësishme që përfshin raportin nga mallrat dhe shërbimet sipas programeve dhe kodeve ekonomike sipas drejtorive që është prezantuar ma herët në këto raporte 3,6,9,12 mujore, po ashtu mungon raporti i mallrave dhe shërbimeve sipas programeve dhe kategorive ekonomike, ku mirët zakonisht periudha krahasuese në këtë rastë viti 2014, kërkoj nga drejtori që në mbledhje të kuvendit të i bashkëngjit këto raporte. Tek raporti i zyrës së prokurimit mendoj se janë të përfshirë edhe disa kontrata që janë lidhë në muajin prill - maj, mendoj se nuk është ashtë dashur të futen në këtë raport. Tek faqja 15 raporti i prokurimit lidhja e kontratave ku kemi një kontratë intervenimet emergjente në infrastrukturë që është lidhë me 4 maj dhe vlera e projektit është 75,000.00 € dhe çmimi për njësi 321.60 € nuk e kam të qartë se për çfarë njësie e ka fjalën, a është beton apo m2 kubëza. Në faqen 14 projekti me numër rendor 0.60 punimi i bazamentit me pilota i objektit të shkollës fillore në Apterush vlera e projektit 123,937.13€ e lidhur me 14 nëntor 2014, po ashtu kemi edhe me 16.06.2014 ritenderim për të njëjtën shkollë fillore në Apterush, pra kemi 2 projekte ku bashkërisht kapin vlerën 600,60.000 €, kërkoj edhe për këtë një sqarim nga drejtori.

**Kryesuesi** – Tek faqja 11 furnizimi me elemente betoni kubëza 18.05 € çmimi për njësi, mendoj se është shumë shtrenjtë sa e di unë çmimi në treg sillet diku rreth 13-14 €. Po ashtu tek viti 2013 kontratat e nënshkruara janë me vlerë 4,882,629.00 € a është e paguar diçka nga kjo shumë apo jo, nëse po është mirë që në mbledhje të kuvendit të na tregoni vlerën edhe sa kanë mbetur pa paguar. Gjithashtu pajtohem me Fatmirin që tek mallrat dhe shërbimet të jetë një raporte për 3 mujorin janar – mars 2015.

**Rasim Fazliu** – Përshëndetje për të gjithë, drejtori na ka ofruar një raporte financiar për 3 mujorin janar - mars 2015, pajtohem me vërejtjet e kolegëve sepse do të ishte ma i kompletuar raporti nëse do të ishin edhe ato pjesë që janë dhanë vërejtje nga kolegët. Realizimi i tatimit në pronë nuk e di se pse është bërë ma i vogël se realizimi i vitit paraprak 2014, ne duhet të kemi tendenca që ta risim realizimin e jo ta zvogëlojmë. Po ashtu furnizimi me elemente betoni kubëza 18.05 € m2 ky është një çmim shumë i lartë, mirëpo kontrata është lidhur me 02.09.2013 dhe sot e kësaj dite vazhdon. Kodi 62 është meremetimi dhe asfaltimi i rrugëve është 62.60 € çmimi për njësi, pyetja ime është a ka të bëj me një m2 asfalt dhe nëse është për një m2 prapë e them se është shumë shtrenjtë.

**Lulzim Sylejmani** – Selimi pyeti për çështjen e m2 tek objektet: për vitin 2014 është për total vitin 505 objekte me 99,000.134 m2, ndërsa për vitin 2015 është vetëm për 3 muaj 37 objekte me 5,000.437 m2, ndërsa tek vlera e faturës dhe numri që të dytat janë vjetore.

Fatmir Iska pyeti për realizimin të hyrave është shumë e vërtet se planifikimi është shumë ma i madh në raporte me realizimin dhe unë e shpjegova ma lartë se cila është arsyeja, por unë besoj se me hyrjen në fuqi të atij ligji dhe me kushtëzimin që do ti bëhet që të paguhet pjesa retroaktive 2009 dhe këndej mendoj se do të plotësohet dhe do të kemi një realizim të të hyrave, po ashtu në shtator do të filloj legalizimi i objekteve mendoj se edhe aty do të kemi një vlerë të realizimit dhe besoj se në fundvit do ta tejkalojmë planifikimin që e kemi për këtë vit. Sa i përket raportit të projekteve përgjigjen kishte mundur të ju japë zyrtari i prokurimit ose menaxherët përkatës për projektet e caktuara. Sa i përket shfrytëzimit të buxhetit në mënyrë analitike për drejtori ne siç e dini kemi kaluar në sistemin e ri të friballancit dhe ato projekte sistemi nuk mundet ende ti realizoj ashtu si i kemi të pasqyruar sepse ende janë duke punuar, por besoj në raportin e 6 mujorit do ta kemi analitiken në sistem. Ndërsa sa i përket vlerës së kontratave të mbetura unë e pranoj si vërejtje, zyra e prokurimit e ka dhe në kuvend do ta kenë. **Kryesuesi** – Besoj se drejtori do i merë parasysh të gjitha vërejtjet që i janë dhanë dhe për kuvend do e plotësoj këtë raporte. Kalojmë në pikën e rallës:

**3. Formimi i komiteteve tjera**, siç e dini me ligjin për vetëqeverisjes lokale dhe me statut të komunës kuvendi i komunës pos komiteteve obligative formon edhe komitete tjera që nuk janë obligative por që i ndihmojnë punët e kuvendit. Është një udhëzim administrativ për formimin e komiteteve konsultative dhe janë komitete të cilat i kushtojnë buxhetit të komunës, pra shkojnë përmes shpalljes së konkursit dhe kryesisht pranohen kuadrat profesionale të cilat i ndihmojnë me këshilla profesionale në lami të caktuar komunës, është shumë e vështirë të realizohen dhe të bëhen funksionale këto komitete për arsye se është shumë problem të vije një ekspert i mirë që të humbë kohën e tij dhe të jepe këshilla profesionale dhe në funde të paguhem me një mëditje prej 30 €. Kryesisht këto komitete përbëhen prej anëtarëve të kuvendit komunal dhe kisha me propozu që këto komitete të mos kenë ma shumë se 5 anëtar dhe të mirët një qëndrim se sa takime munden ti kenë brenda vitit, gjitha këto komitete parashihen të paguhen në vitin 2016. Unë kam menduar që të formohen 4 komitete tjera:

**1. Komiteti për ekonomi, bujqësi dhe turizëm, 2. Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport, 3. Komiteti për shëndetësi, mirëqenie sociale dhe për persona me aftësi të kufizuar, 4. Komiteti për urbanizëm, gjeodezi, pronë dhe inspektion.**

Komitetin për shërbime publike nuk e kam futur këtu për shkak se është një komitet i përkohshëm me projektin e Demosin, pra me këtë komitet janë gjithsej 5 komitete tjera.

**Fatmir Iska** – Është shumë problem të ftohen njerëz ekspertë për arsye materiale, për 30 € nuk besoj se do të vije nodikush të jepe dije, përndryshe shumë mirë që janë duke u formuar këto komitete dhe mendoj se këto komitete nuk është nevoja të kenë shumë anëtar, ne duhet të shkojmë në minimum dhe të përfshihen të gjithë që janë në kuadër të administratës.

**Selim Duraku** - Komitetet që janë formuar ma herët kanë pas probleme rreth pagesave, ka qenë komisioni që është formuar për stacionin e autobusëve që nuk i është bërë kurrfarë pagese, këto pagesa a do të bëhen nga buxheti i kuvendit apo secila drejtori do ti paguaj komitetit të vet përkatës.

**Kryesuesi** - Kuvendi do ta përgatis një propozim vendim për këto 4 komitete tjera dhe në mbledhje të kuvendit to të aprovohet, çështjen e mëditjeve do ta shqyrtojmë kur ta hartojmë kornizën afatmesme buxhetore, kalojmë në pikën fundit të rendit të ditës :

**4. Të ndryshme**, meqenëse konkursi për ndarje të bursave për studentët ka përfunduar dhe komisioni e ka kryer punën e vet ne duhet ta formojmë një komision ad - hoc tjetër për shqyrtimin e ankesave sepse atë komision që e kemi formuar në mbledhjen e kaluar të kuvendit na është dhanë vërejtje nga ana e MAPL-së, sepse me rregulloren për ndarje të bursave komisioni ad – hoc duhet të jetë prej 5 anëtarëve e jo 3. Nga 5 anëtarë 2 duhet të jenë nga kuvendi, 2 nga ekzekutivi dhe 1 nga shoqëria civile.

**Fatmir Iska** – Kam bërë një pyetje në seancën e kaluar për shkollën “ 7 shtatori” për gjendjen e klasave të saj që janë në një gjendje katastrofe, por e pashë në portale se është bërë lyerja e atyre klasave dhe me vije mirë që ka ndikuar pyetja ime. Dua ta ngris një çështje e kjo shkon për drejtorin e shërbimeve publike, është bërë pastrimi i mbeturinave të ngurta në dalje të qytetit pa i përfill procedurat e tenderimit, pra është pastruar diçka pa tender dhe ma e keqja është se dikush tjetër ka

pastruar mbeturinat ndërsa dikush tjetër është operator ekonomik me letra. Drejtori i shërbimeve publike është duke krijuar një paralele jo të barabartë për deri sa i pastron mbeturinat e ngurta pa kurrfarë tenderi, të njëjtën çështje e kemi nga kolegu Rasim Fazliu që i ka bërë pyetje në seancat e kaluara për dheun që është shembur në rrugën Celin – Fortes, unë kam kaluar në atë rrugë dhe ishte një shembje koça e gjatë dhe në një kthesë që paraqet rrezik koça të madh në komunikacion, drejtori i përgjigjet z. Rasimit se nuk mundet me e pastru atë rrugë sepse nuk është lidhë tenderi ende, pra ai diku mundet dhe diku nuk mundet për mu kjo është shumë e paqartë. Çështja tjetër është për rrugën Vëllezërit Haradinaj, një pjesë është përfunduar dhe është me kanalizim, ndërsa pjesa tjetër diku rreth 200 ose 300 m është duke rregulluar rruga dhe do të shtrohet asfalt por kjo rrugë është pa kanalizim, kjo rrugë është tek podrumi i Selami Shehut dhe ky zotëri e ka kanalizim e vet privat por drejtori thotë se është mare vesh me personin në fjalë dhe në këtë kanalizim mund të lidhen edhe qytetarët e tjerr që i përkasin kësaj rruge 300 m, sa do të jetë funksional ky kanalizim kur ai është ndërtuar vetëm për nevojat e tij personale dhe nesër kjo lagje mundet të urbanizohet dhe sa do të ketë efekte ky kanalizim pastaj, pra prapë duhet të prishet rruga dhe të futet kanalizimi tjetër. Kërkojmë edhe nga kryetari përgjegjësi për këtë punë kur nuk ka kanalizim si mundet të shtrohet rruga me asfalt. Më kujtohet një raporte për punët e përfunduara në vitet paraprake 2011,2012,2013 ku thotë se në kapakët e pusetave është paraparë paramasa 0.30 cent dhe që vlera e tij në hekurishte mundet të bëjë diku 15 €, ndërsa tash vetë e ka ngritë çmimin 3 fishë ma shumë prej 0.30 cent e ka bërë 1.00 €, unë mendoj se ky drejtor nuk dinë të ndalet me keq menaxhimin e vetë që është duke e bërë. Unë nuk e di se a është i njoftuar kryetari i komunës për punët që është duke i bërë ky drejtor.


**Kryesuesi** - Sa i përket pyetjeve shërbimi teknik i kuvendit i ka adresuar drejtorëve të gjitha pyetjet që i keni bërë në mbledhjen e kuvendit me shkrim dhe po ashtu përgjigjet do i merrni me shkrim. Kishte me qenë mirë që në të ardhmen edhe pyetjet ti bëni me shkrim dhe drejtorët do të jenë më të obliguar që ti përgjigjen pyetjeve të juaja. Faleminderit për pjesëmarrje shihemi në takimet e tjera.

Mbledhja ka përfunduar në ora 11.00.

Procesmbajtësi,  
Skender Hamza



Kryesuesi,  
Nahit Elshani



-III- Nr. l prot 2110 Më 15.05 2010  
Br. prot. Dt. 15.05 2010  
RAHOVEC - ORAHOVAC